Etniteti i nëpunësve




| | |
|---|---|
| Shqiptarë | 1024 |
| I/e pa deklaruar | 118 |
| Serb | 3 |
| Të tjerë | 1 |
| **Total:** | **1146** |

**Gjinia e nëpunësve / Employee gender profile**

| | |
|---|---|
| Mashkull | 634 |
| Femër | 512 |
| Total: | 1146 |



**Administrata Publike**

Në tabelë janë dhënë Institucionet e administratës dhe kapacitetet hapësinore. Janë identifikuar institucionet, përkatësisht objektet përcjellëse të tyre, që shtrihen në kuadër të territorit të Komunës së Vitisë.



*Objekti i Administratës Komunale Viti*

| Institucionet administrative | Vendbanimi | Sip. e parcelës (ha) | Sip. e parcelës m² | Nr. i kateve |
|---|---|---|---|---|
| Objekti i komunës së re | Viti | 0.54217 | 5421.7 | Objekti i komunës së re |
| Objekti i komunës së vjetër | Viti | 0.29489 | 2948.9 | Objekti i komunës së vjetër |
| Objekti i kryetarit të komunës | Viti | 0.14112 | 1411.2 | Objekti i kryetarit të komunës |
| Agjencia e Regjistrimit Civil dhe muzeu i komunës | Viti | 0.14112 | 1411.2 | Agjencia e Regjistrimit Civil dhe muzeu i komunës |
| Gjykata Themelore, Dega ne Viti dhe Stacioni policor | Viti | 0.22549 | 2254.9 | Gjykata Themelore, Dega ne Viti dhe Stacioni policor |
| Objekti i ish Drejtorisë për Arsim | Viti | 0.11631 | 1163.1 | Objekti i ish Drejtorisë për Arsimit |
| Objekti i Ri i Zjarrfikësve | Viti | 0.44986 | 4498.6 | Objekti i Ri i Zjarrfikësve |
| Objekti i vjetër i zjarrfikësve | Viti | 0.66378 | 6637.8 | Objekti i vjetër i zjarrfikëseve |
| Qendra për Pune dhe Mirëqenie Sociale | Viti | 1.29052 | 12905.2 | Qendra për Pune dhe Mirëqenie Sociale |
| Gjithsej | 3.86526 | 38652.6 | Gjithsej | 3.86526 |

*Tab.18. Institucionet e administratës dhe kapacitetet hapësinore*

**Ofrimi i shërbimeve**

Ofrimi i shërbimeve publike administrative për qytetarët, bizneset dhe OJQ-të në formë të çertifikatave, vendimeve, aktvendimeve, pëlqimeve etj, është obligim kryesor I komunës. Komuna e Vitisë ofron mbi 90 shërbime publike administrative për kategoritë e lartcekura. Këto shërbime ofrohen nëpërmjet zyrtarëve të gjendjes civile. Gjithashtu administrata e ka të digjitalizuar sistemin e shërbimeve, ku aktualisht e kemi një E-kiosk  e vendosur në fshatin më të madh të komunës, në Pozheran, ku ofron shërbim digjital për çertifikata.



**Shërbimet digjitale për qytetar**


**Digjitalizimi i shkollave**

SZHEL – Plani i mobilitetit


**Sheshi Calmy Rey**


**Rr. "Kongresi i Manastirit**



Prapa objektit te postës

# KAPITULLI II
# SFIDAT E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL

## Sektori privat

Tregjet e jashtme dhe eksportimi i mallrave ne këto tregje mbetet sfidë kryesore e prodhuesve vendor dhe bizneseve komunale. Prodhuesit vendor do të ngritnin kapacitetet prodhuese dhe punësimin sikur të siguronin eksportimin e prodhimeve të tyre në tregjet e jashtme. Pra, sfidë e bizneseve të komunës mbetet gjetja e tregjeve të jashtme.

Në Komunën e Vitisë sfidë tjetër në sektorit privat mbetet prania e madhe e ekonomisë joformale, çoftë nga aspekti i deklarimit të punëtorëve si edhe në aspekt të pagesës së tatimeve. Për vitin 2020 në Komunën e Vitisë zhvillojnë aktivitetin 1197 ndërmarrje, me gjithsej 3866 të punësuar, që do të thotë se, mesatarja e numrit të punësuar për një ndërmarrje në Komunën e Vitisë është 3.22 punëtor. Kjo statistikë tregon edhe shkallën e informalitetit ekonomik në Komunën e Vitisë krahas numrit të ndërmarrjeve dhe të të punësuarve.

Sfidë tjetër është varësia e madhe buxhetore e nivelit lokal nga grandet qeveritare dhe grande nga organizata të ndryshme joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare si dhe diaspora. Pra, Komuna e Vitisë bënë pjesë në grupin e komunave me kapacitet të kufizuar buxhetore dhe si e tillë është e hendikepuar në realizimin e objektivave ekonomike komunale pa përkrahjen nga faktorët e jashtëm të interesit siç janë: grandet qeveritare, grandet e OJQ-ve dhe diaspora.

Klima jo shumë e favorshme e nivelit lokal për joshjen e investimeve të huaja direkte dhe mungesa e strategjive lokale për fuqizim të kapitalit njerëzor për nevojat e punës gjithashtu mbetet sfidë. Bizneset komunale të Vitisë po përballen me mungesë të punonjësve të kualifikuar dhe si rezultat edhe oferta për investime komunale është e varfër, ngase bizneseve po ju merr kohë derisa po i aftësojnë punëtorët për ushtrimin e punës profesionale nëpër biznese.

Sfidë e zhvillimit ekonomik lokal është mungesa e hartës investive (oferta për investitorët potencial). Gjithashtu sfidë është ikja e fuqisë punëtore (fizike dhe profesionale) në botën e jashtme (migrimi), që Vitia e ka si fuqi potenciale të zhvillimit ekonomik lokal.

Përkrahja jo e mjaftueshme me grande investive për rinin dhe gjininë femërore në biznese startup. Vitia me potencialin e vet kadrovik, rinin dhe gjininë femërore mund të siguroj zhvillim ekonomik komunal po të kishte numër më të madh të grandeve startup. Prandaj, kjo mbetet sfidë e zhvillimit ekonomik lokal.

## Bujqësia

- Mungesa e infrastrukturës bujqësore (rrugët bujqësore, sistemet e ujitjes, mungesa e kanaleve) është sfidë për bujqit të cilët merren me veprimtari bujqësore që ka ndikim në zhvillimin ekonomik lokal.
- Sfidë komunale mbetet prerja dhe dëmtimi i pyjeve në forma ilegale dhe të pakontrolluar dhe mbrojtja e tyre nga dëmtuesit klandestin. Struktura racore e gjedheve mbetet jo kualitative dhe si rezultat kemi produkte të vogla që ndikon edhe në përformancën e prodhuesve të

qumështit dhe produkteve të tyre dhe mishit. Gjithashtu sfidë vazhdon të mbetet niveli joadekuat i teknologjisë dhe agroteknikës. Pra, mungon teknika bashkëkohore e zhvillimit bujqësor.

- Mungesa e kapaciteteve për përpunimin, konservimin, magazinimin dhe hapësirën për tregtimin e produkteve bujqësore është një nga sfidat e rëndësishme të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal, me të cilat po përballën prodhuesit bujqësor, të cilët nuk e kanë të mbrojtur prodhimin dhe të sigurt plasmanin në treg.
- Niveli jo adekuat i transferimit të njohurive dhe aplikimit të inovacioneve dhe teknologjive të reja është kusht i domosdoshëm për ngritjen e kualitetit të prodhimit dhe rendimenteve të produkteve bujqësore. Po ashtu kapitali financiar i pamjaftueshëm vazhdon të na përcjell si sfidë e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit bujqësor.

## Shërbimet publike

Sfidë e shërbimeve publike mbetet mirëmbajtja e infrastrukturës publike dhe mungesa e buxhetit jo të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e infrastrukturës. Dëmtimi i asfaltit, trotuarit pa u njoftuar institucionet komunale gjithashtu sfidon në kryerjen e shërbimeve efikase dhe mirëmbajtjen efektive.

## Shëndetësia dhe mirëqenia sociale

Edhe sektorin e shëndetësisë e përcjellin një varg sfidash: Mungesa e kapaciteteve për ofrimin e shërbime specialistike; Mungesa e kushteve dhe kapaciteteve të nevojshme për trajtimin e pacientëve me sëmundje kronike; Mungesa e pajisjeve dhe aparateve bashkëkohore dhe teknologjisë për diagnostifikimin e sëmundjev Niveli joadekuat i edukimit shëndetësor të qytetarëve dhe njohuritë e pamjaftueshme për praktikim të mënyrave të shëndetshme të ushqimit dhe jetesës tek mirëqenia sociale janë mungesa e burimeve njerëzore profesionale; mungesa e një psikologe te shërbimet sociale, mungesa e infrastrukturës së duhur për shërbime sociale, mungesa e hapësirës së nevojshme e një qendre për shërbime të veçanta.

## Arsimi

Zhvillimet negative demografike kanë pas pasoja negative në sistemin arsimor, andaj sfidë në arsim paraqet numri i vogël i nxënësve nëpër shkolla. Kjo ka prodhuar si pasojë sfidën tjetër, tepricën e mësimdhënësve, pra numrin e madh të mësimdhënësve në raport me numrin e nxënësve; Mungesa e kushteve të nevojshme për arsimimin e nxënësve me nevoja të veçanta; Mungesa e rregullativës ligjore për definimin e statusit (pensionimi i parakohshëm) dhe trajtimin e mësimdhënësve me sëmundje të rënda; Mungesa e theksuar e kuadrit mbështetës, psikologëve, pedagogëve në sistemin arsimor; Buxheti i pamjaftueshëm për funksionimin normal të mësimit nëpër shkolla; Rrjeti i pamjaftueshëm i sistemit parashkollor nëpër të gjitha zonat; Mungesa e rrjetit të bibliotekave nëpër shkolla dhe mungesa e fondit të librave nëpër ato ekzistuese.

SWOT-analiza

Swot-analiza është instrument me anë të të cilit përmes analizës së informatave dhe të dhënave relevante bëhet vlerësimi i gjendjes dhe klasifikimi i njohurive në fusha të caktuara. SWOT-analiza mundëson identifikimin e kapaciteteve të cilat mund të aktivizohen dhe zhvillohen, mundësitë të cilat mund të shfrytëzohen, dobësitë që duhet të merren parasysh, dhe rreziqet të cilat është e nevojshme të minimizohen. Në SWOT-analizë janë përfshirë të gjithë segmentet të cilat janë objekt i analizës socio-ekonomike. Kjo ka mundësuar qe te definohen kahet dhe orientimet e veprimet në tri drejtime: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, Zhvillimi i qëndrueshëm social dhe Menaxhimi i qëndrueshëm.

ZHVILLIMI EKONOMIK

| Përparësitë: | Dobësitë: |
|---|---|
| - Resurset njerëzore;<br>- Sektori privat mjaft i zhvilluar;<br>- Numri i konsiderueshëm I ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;<br>- Rrjeti i zhvilluar i tregtisë me pakicë dhe shumicë<br>- Industria përpunuese;<br>- Rrjeti mjaft i zhvilluar i aktiviteteve shërbyese dhe zejtare;<br>- Përcaktimi i zonave industriale;<br>- Kushtet relativisht të volitshme klimatike, konfiguracioni i terrenit, boniteti i tokës për zhvillimin e bujqësisë;<br>- Lokacionet e përshtatshme për zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme nga dielli dhe era;<br>- Tradita e kultivimit të prodhimeve bujqësore;<br>- Terreni i volitshëm për zhvillimin e blegtorisë; | - Qasja e dobët në tregjet e jashtme dhe niveli i ultë i exportit;<br>- Prania e dukshme e ekonomisë informale;<br>- Statusi i pa rregulluar i të punësuarve në sektorin privat;<br>- Kapitali financiar i pamjaftueshëm. Varësia e madhe financiare nga grandet qeveritare dhe të donatorëve të ndryshëm;<br>- Mobilizimi i dobët i potencialeve financiare sidomos diasporës;<br>- Mungesa e kuadrit të kualifikuar dhe specialistëve;<br>- Përdorimi i teknologjive të vjetruara;<br>- Ambienti jo i volitshëm për joshjen e investimeve të huaja;<br>- Migrimi i fuqisë punëtore; |

| | |
|---|---|
| - Ekzistimi i sipërfaqeve të konsiderueshme pyjore dhe kullosave;<br>- Investimet përmes subvencionimit dhe ndarja e garantëve për zhvillimin e Bujqësisë;<br>- Kushtet e volitshme për zhvillimin e turizmit<br>- Rrjeti i zhvilluar i Agjencioneve Turistike;<br>- Diaspora si potencial i konsiderueshëm financiar dhe si mundësi e transferit të përvojës dhe praktikave të jashtme dhe urë lidhëse me botën e jashtme;<br>- Implementimi i projekteve te BERZh-it. | - Sistemi jo efikas i menaxhimit të resurseve (tokës, ujit, pyjeve);<br>- Numri i madh i parcelave të vogla të tokës së punueshme;<br>- Mungesa e sistemit të ujitjes;<br>- Fondi blegtorali dobët, struktura racore e pa avancuar;<br>- Sipërfaqja e vogël me pemë dhe perime, produktiviteti i ulët dhe asortimenti I varfër i produkteve;<br>- Mungesa e kapaciteteve për përpunimin, konservimin dhe magazinimin e produkteve bujqësore;<br>- Mungesa e hapësirës dhe infrastrukturës për promovimin, ekspozimin dhe shitjen e prodhimeve dhe produkteve bujqësore dhe mungesa e zinxhirit tregtar. |
| Mundësitë | Rreziqet |
| - Funksionalizimi dhe aktivizimi i zonës industriale;<br>- Promovimi i partneritetit publiko-privat;<br>- Krijimi I kushteve të volitshme për biznesin përmes lehtësirave fiskale dhe thjeshtëzimit të procedurave administrative;<br>- Lehtësimi dhe ndihmini për qasje në absorbimin e garantëve dhe fondeve për zhvillim;<br>- Ndihmini dhe mundësimi i kontaktit dhe bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe asociacionet që përkrahin biznesin;<br>- Krijimi i mundësive për bashkëpunim me asociacionet vendore dhe ndërkombëtare dhe qasje në tregjet e jashtme; | - Kriza ekonomike globale;<br>- Monitorimi dhe kontrolli i ulet i normave dhe standardeve të punës;<br>- Monitorimi dhe kontrolli i ulet i normave dhe standardeve të cilësisë së prodhimeve;<br>- Mundësia e vërshimit të tregut me teknologji të vjetërsuar;<br>- Mungesa e rregullatives ligjore dhe aplikimi i ulët i asaj ekzistuese.<br>- Fatkeqësitë natyrore;<br>- Shpejtësia dhe vëllimi i ndryshimeve teknologjike;<br>- Mungesa e fondeve dhe kushtet e pavolitshme të kreditimit; |

| | |
|---|---|
| - Fuqizimi i bashkëpunimit dhe lidhshmëria me institucionet arsimore dhe kërkimore-shkencore;<br>- Ndërtimi i sistemit të ujitjes;<br>- Mbështetja e pjesëmarrjes në panaire dhe tregje për ekspozimin, tregtimin e prodhimeve bujqësore dhe prezantimit të inovacioneve dhe teknologjive të reja prodhuese;<br>- Ngritja e kapaciteteve për përpunimin, konservimin dhe magazinimin e prodhimeve bujqësore;<br>- Rritja e fondit blegtoral;<br>- Themelimi i qendrës inovative për bujqësi;<br>- Zgjerimi i asortimentit të prodhimeve bujqësore;<br>- Zhvillimi i eko-turizmit dhe turizmit kulturor. | - Zhvillimi jo i balancuar regjional;<br>- Produktiviteti i ulët dhe jorentabil;<br>- Zhvillimi i pa harmonizuar dhe jo i balancuar sektorial;<br>- Aftësia e ulët konkurruese në treg. |

ZHVILLIMI SOCIAL

| Përparësitë: | Dobësitë: |
|---|---|
| - Rrjeti i zhvilluar i rrugëve lokale;<br>- Rrjeti i zhvilluar i institucioneve arsimore (parashkollor, fillor dhe I mesëm);<br>- Shkalla mjaft e lartë e përgatitjes profesionale e stafit arsimor;<br>- Përfshirja e nxënësve me pengesa në zhvillim në sistemin arsimor dhe realizimi i programeve të veçantë për integrim;<br>- Rrjeti relativisht i zhvilluar i institucioneve shëndetësore;<br>- Bashkëpunimi dhe ndërveprimi i mirë me nivelet e tjera të sistemit shëndetësor, sidomos sekondar dhe terciar; | - Mirëmbajtja joadekuate dhe mungesa e fondeve të mjaftueshme për mirëmbajtje;<br>- Dëmtimi i asfaltit dhe trotuareve pa lejen dhe pa njoftimin e organit përgjegjës;<br>- Pajisja jo e mirë e kabineteve dhe punëtorive për mësim praktik;<br>- Harmonizimi i pamjaftueshëm i drejtimeve arsimore me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimit të përgjithshëm shoqëror;<br>- Niveli mjaft i ulët i bashkëpunimit dhe koordinimit mes sektorit privat dhe institucioneve arsimore;<br>- Sistemi mjaft I kufizuar i edukimit shëndetësor dhe preventivës shëndetësore; |

| | |
|---|---|
| - Realizimi i trajtimit shtëpiak dhe sistemit të patronazhit për personat me invaliditet dhe ata të palëvizshëm;<br>- Ekzistimi i një numri të konsiderueshëm të klubeve, organizatave dhe OJQ-ve sportive;<br>- Zhvillimi i një numri të konsiderueshëm të disiplinave sportive (futboll, basketboll, hendboll, shah, çiklizëm, shenjëtari, futsal, etj.);<br>- Infrastruktura relativisht e zhvilluar sportive (tri stadiume për zhvillimin e garave dhe dy stadium ndihmëse, ,palestra sportive në ndërtim, dhjetëra fusha sportive nëpër shkolla që janë në funksion të zhvillimit të aktiviteteve sportive, etj.);<br>- Rrjeti i zhvilluar i OJQ-ve dhe asociacioneve të shoqërisë civile;<br>- Ekzistimi i shoqërive kulturo-artistike që zhvillojnë aktivitete në fusha të ndryshme;<br>- Ekzistimi i TV-lokale dhe mediave elektronike.<br>- Implementimi i skemës sociale;<br>- Subvencionimi i kategorive të rrezikuara sociale;<br>- Organizimi dhe zhvillimi i veprimtarive humanitare dhe aksioneve të solidaritetit. | - Mungesa e kuadrit të nevojshëm profesional të specializuar;<br>- Mungesa e pajisjeve dhe aparaturave modern për diagnostikim;<br>- Zhvillimi i pamjaftueshëm ekonomik.<br>- Mungesa e hapësirë dhe infrastrukturës së nevojshme për shërbime sociale;<br>- Mungesa e profileve të caktuara profesionale.<br>- Rritja e sjelljeve devijante tek të rinjtë;<br>- Gjendja e pavolitshme material e klubeve sportive;<br>- Infrastruktura e pamjaftueshme sportive.<br>- Statusi i padefinuar pronësoro-juridik i objekteve sportive;<br>- Financimi jo i rregullt dhe i pamjaftueshëm i manifestimeve dhe aktiviteteve kulturore e sportive. |
| Mundësitë | Rreziqet |
| - Bashkëpunimin ndërkomunal dhe ndërkombëtar.<br>- Fuqizimi i standardeve urbane;<br>- Zgjerimi dhe funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit;<br>- Zgjerimi dhe funksionalizimi i rrjetit të kanalizimit dhe realizimi i projekteve për trajtimin e ujërave të zeza;<br>- Ngritja dhe avancimi i kapaciteteve për menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave;<br>- Avancimi dhe modernizimi i sistemit arsimor; | - Mos realizimi i projekteve të nevojshme infrastrukturore;<br>- Mungesa e resurseve ujore për furnizimin e rrjetit të ujësjellësit;<br>- Mungesa e fondeve për mirëmbajtjen e infrastrukturës;<br>- Mbyllja e shkollave në viset rurale;<br>- Mungesa e sistemit të sigurimit shëndetësor; |

| | |
|---|---|
| - Monitorimi dhe vlerësimi kontinual i cilësisë së procesit mësimor;<br>- Fuqizimi i partneritetit të sektorit privat me institucionet arsimore;<br>- Profilizimi i shkollës profesionale sipas nevojave të tregut të punës dhe në funksion të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror;<br>- Avancimi dhe modernizimi I sistemit shëndetësor;<br>- Zgjerimi i rrjetit të Mbrojtjes primare shëndetësore dhe shtimi i shërbimeve shëndetësore conform nevojave për ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore;<br>- Bashkëpunimi me partner (shoqata, asociacione, inciative, etj) për trajtimin e kategorive të rrezikuara sociale;<br>- *Rritja e pjesëmarrjes aktive dhe fuqizimi i rolit të rinisë në proceset e zhvillimit shoqëror;*<br>- Përfundimi dhe funksionalizimi i palestrës sportive;<br>- Ndërtimi i infrastrukturës për zhvillimin e disciplinave tjera sportive;<br>- Zhvillimi, mbështetja e sporteve dhe sportistëve elitarë (reprezentuesve). | - Rritja e numrit të të sëmurëve me sëmundje kronike;<br>- Niveli jo adekuat i edukimit shëndetësor të qytetarëve dhe njohuritë e pamjaftueshme për praktikimin e mënyrave të shëndetshme të ushqimit dhe jetesës;<br>- Kapaciteti i limituar buxhetor.<br>- Mungesa e stafit të duhur profesional;<br>- Zhvillimi jo i balancuar sektorial;<br>- Migrimi i kuadrove profesionale dhe rinisë;<br>- Pamundësia e klubeve për zhvillimin e aktivitetit;<br>- Ndryshimi negativ në sjelljet dhe shprehitë e të rinjve (qëndrimi i gjatë pranë kompjuterëve dhe videolojërave, qëndrimi i zgjatur i të rinjve në bare dhe lokale të natës, etj.);<br>- Përhapja e shprehive devijonte tek të rinjtë (alkooli, droga, dhuna);<br>- Mungesa e strategjisë nacionale në shumë fusha të zhvillimit të shoqërisë;<br>- Migrimi i talenteve sportive;<br>- Apatija dhe mungesa e iniciativës;<br>- Procedurat burokratike që demotivojnë të rinjtë;<br>- Kriza ekonomike që si pasojë ka rritjen e papunësisë dhe të varfërisë;<br>- Mungesa e solidaritetit. |

MENAXHIMI I QËNDRUESHËM

| Përparësitë: | Dobësitë: |
|---|---|
| - Kapacitetet institucionale të konsoliduara;<br>- Kapacitet njerëzore të zhvilluara dhe përvoja e tyre;<br>- Infrastruktura bazike në të gjitha lokalitetet e banuara;<br>- Përvoja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional dhe ndërkomunal;<br>- Hapësira e konsiderueshme për punë;<br>- Plani zhvillimor komunal i miratuar;<br>- Përvoja e mirë e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe asociacionet e ndryshme;<br>- Rrjeti i zhvilluar shkollor dhe sigurimi I qasjes për të gjithë;<br>- Shtrirja relativisht e mirë e rrjetit të Shëndetësisë primare;<br>- Pajisja e mirë teknike e Administratës Komunale dhe fleksibiliteti I stafit; | - Kapacitetet buxhetore të limituara;<br>- Mungesa e hapësirës dhe infrastrukturës së nevojshme e Qendrës për punë sociale;<br>- Rrjeti I ndriçimit i pa zhvilluar në të gjitha lokalitetet;<br>- Mungesa e rrjetit te ujësjellësit dhe kanalizimit në disa lokalitete;<br>- Harmonizimi dhe koordinimi jo i mjaftueshëm me institucionet qendrore;<br>- Përgatitja profesionale jo adekuate e kuadrove udhëheqëse;<br>- Mosdefinimi i qartë i nivelit regjional të qeverisjes. |
| Mundësitë | Rreziqet |
| - Zgjerimi i kompetencave të qeverisjes lokale;<br>- Avancimi i institucioneve ekzistuese;<br>- Promovimi dhe afirmimi I praktikave të partneritetit publiko-privat;<br>- Qasja në fonde të ndryshme zhvillimore dhe animimi i donatorëve;<br>- Aplikimi i teknologjive modern.<br>- Implementimi i modeleve dhe praktikave bashkëkohore në menaxhim;<br>- Ngritja e kualitetit të shërbimeve të Administratës Komunale. | - Procedurat jo efikase administrative;<br>- Kufizimet për rekrutimin e stafit nga niveli qendror;<br>- Procedurat burokratike dhe kufizimet në ushtrimin e plotë të kompetencave në nivelin lokal;<br>- Mospërputhja e ndarjes së buxhetit me numrin e banorëve;<br>- Mungesa e rregullatives ligjore ne shumë fusha dhe mosharmonizimi me përvojat praktike. |

# KAPITULLI III

## OBJEKTIVAT E SHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL

**1. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK:** *Forcimi i ekonomisë komunale, nxitja e zhvillimit ekonomik me qëllim rritjen e punësimit*

**1.1 Krijimi i ambientit atraktiv për investime**

1.1.1 *Investime infrastrukturore në Zonën Ekonomike Komunale, funksionalizimi dhe zgjerimi deri në vitin 2025 me 1100 të punësuar brenda 4 viteve*

1.1.1.1 Përfundimi në tërësi i infrastrukturës dhe ndarja e parcelave në bazë të raportit të fizibilitetit deri në vitin 2023

1.1.1.2 Thirrje publike për dhënien në shfrytëzim të parcelave sipas kritereve të përcaktuar në thirrjen publike deri në vitin 2024

1.1.1.3 Studimi i fizibilitetit për zgjerimin e Zonës Ekonomike Komunale për 8.5 hektar deri në vitin 2025

1.1.1.4 Ndërtimi i infrastrukturës bazike dhe krijimi i kushteve për aktivizimin e zonave të reja biznesore

**1.2 Nxitja e ndërmarrësisë së re (biznese të reja startup)**

*1.2.1 Stimulimi i zhvillimit ekonomik përmes investimeve të huaja dhe vendore*

1.2.1.1 Krijimi i hartës komunale për investime (Oferta për investitor potencial)

1.2.1.2 Ofrimi i konsulencave, këshillime në vazhdimësi për biznese

1.2.1.3 Krijimi i kushteve të favorshme për investitor (rregullimi i shpejt i dokumenteve regjistruese, vazhdimi i lirimit nga taksat)

1.2.1.4 Renovimi i objektit për inkubator biznesi

1.2.1.5 Krijimi i inkubatorëve biznesor (përgatitja e trupave profesionale për hapjen e bizneseve dhe dhënia e grandeve për startup biznese)

1.2.1.6 Bashkëpunimi DZHE-DKA në mënyrë periodike të kryejnë analizën dhe vlerësimin e nevojave të tregut dhe zhvillimin e programeve me qëllim të avansimit të aftësive dhe shkathtësive profesionale

1.2.1.7 Planifikojmë hapjen e 450 bizneseve të reja (të vogla dhe të mesme) dhe punësimi i 2500 punëtorëve deri në vitin 2026

1.3 **Rritja e kapaciteteve të ndërmarrjeve ekzistuese**

*1.3.1 Rritja e prodhimit lokal*

1.3.1.1 Dhënia e grandeve në partneritet me Qeverinë dhe OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare për pika grumbulluese në sektorin e bujqësisë

1.3.1.2 Gjetja e tregjeve të jashtme, bashkëpunimi biznese-oda ekonomike-institucione

1.3.1.3 Mbajtja e një konference investive me investues potencial në Komunën e Vitisë në vitin 2023 (identifikimi i investitorëve potencial)

**1.4 Promovimi i Partneritetit Publiko Private (PPP)**

*1.4.1 Nxitja e investimeve përmes PPP-së*

1.4.1.1 Bashkëpunimi ndërinstitucional (qendror dhe lokal)

1.4.1.1 Funksionalizimi i Grupit Punues (GP) për PPP-në

1.4.1.2 Krijimi i Listës së projekteve për PPP-në
1.4.1.3 Përzgjedhja e katër projekteve potenciale për PPP-në
1.4.1.4 Sigurimi i fondeve për studimin e fizibilitetit për projektet deri në vitin 2024
1.4.1.5 Hartimi dhe realizimi i së paku 2 projekteve të PPP-së deri në vitin 2026

**1.5 Zhvillimi i turizmit lokal**

*1.5.1 Zhvillimi i turizmit përmes konceptit të bazuar në resurset natyrore dhe trashëgiminë kulturo-historike*

1.5.1.1 Themelimi i zyrës informuese
1.5.1.2 Shënjimi i objekteve dhe zonave të kategorizuara me vlerë kulturo-historike dhe vendosja e tabelave orientuese
1.5.1.3 Restaurimi, konservimi dhe mirëmbajtja e objekteve me vlerë të trashëgimisë kulturo-historike.
1.5.1.4 Përcaktimi i zonave me potencial për zhvillimin e turizmit natyror
1.5.1.5 Ndërtimi i infrastrukturës dhe krijimi i kushteve për zhvillimin e turizmit
1.5.1.6 Zhvillimi i rrjetit të veprimtarive shërbyese dhe ngritja e kapaciteteve akomoduese nëpër zonat me potencial për zhvillimin e turizmit (bujtina, restorane, hotele
1.5.1.7 Organizimi vjetor i panairit bujqësor me qëllim të prezantimit dhe promovimit të resurseve dhe produkteve vendore në funksion të zhvillimit të turizmit lokal si dhe organizimi i aktiviteteve dhe veprimtarive kulturore me qëllim të prezantimit dhe afirmimit të vlerave të trashëgimisë kulturore

**1.6 Ndërtimi i sektorit efikas dhe të qëndrueshëm bujqësor me potenciale të fuqizuara për rritjen e prodhimtarisë primare dhe kapacitete të avancuara për përpunimin dhe distribuimin e prodhimeve bujqësore**

*1.6.1 Zhvillimi dhe avancimi i sistemit bujqësor i cili me produktivitetin dhe prodhimet e veta mund të përballoj konkurrencën në treg dhe si i tillë të siguroj të ardhura stabile dhe të gjeneroj punësim*

1.6.1.1 Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore për bujqësi, mbrojtja dhe ruajtja e tokës bujqësore, rritja e sipërfaqeve bujqësor edhe garantimi i çasjes në tokën bujqësore
1.6.1.2 Përkrahja dhe fuqizimi i prodhimtarisë primare
1.6.1.3 Zhvillimi, avancimi dhe fuqizimi i prodhimtarisë bujqësore (rritja e kapaciteteve dhe aftësive konkurruese në treg)
1.6.1.4 Modernizimi i Bujqësisë, zhvillimi dhe avancimii aftësive dhe shkathtësive për aplikimin e njohurive, inovacioneve dhe teknologjive të reja
1.6.1.5 Zhvillimi dhe avancimi i kapaciteteve për përpunimin e prodhimeve bujqësore
1.6.1.6 Zhvillimi i sektorit të blegtorisë dhe menaxhimi efikas i pyjeve dhe kullosave (zhvillimi dhe avancimi i sektorit të blegtorisë)
1.6.1.7 Kujdesi dhe mirëmbajtja e pyjeve dhe kullosave dhe menaxhimi efektiv i tyre
1.6.1.8 Zhvillimi rural dhe mbrojtja e ambientit (zhvillimi i balancuar i zonave rurale)
1.6.1.9 Fuqizimi i normave dhe standardeve per mbrojtjen e mjedisit
1.6.1.10 Shfrytëzimi i resursit ujor nga Morava me prrockat rreth saj për zhvillimin e bujqësisë (rregullimi i infrastrukturës ujore).

**2. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM SOCIAL:** *Sigurimi dhe garantimi i qasjes së barabartë në institucionet komunale për të gjithë qytetarët. Avancimi dhe modernizimi i sistemit shëndetësor, arsimor dhe shërbimeve sociale*

**2.1 Përmirësimi i kushteve dhe ngritja e kualitetit të ambientit jetësor**

*2.1.1 Infrastrukturë moderne të jetës (asfaltim i rrugëve, trotuareve, ndriçimi publik, ujësjellësi, kanalizimi etj)*

2.1.1.1Asfaltimi i rrugës në Stubëll e Epërme, rruga prej "Anton Qeta" deri te rruga "Sejdiu",faza 2

2.1.1.2 Asfaltimi i rrugës Mjak-Debelldeh

2.1.1.3 Rregullimi i sheshit "Calmy Rey"; rruga "Kongresi i Manastirit"; rregullimi i hapësirës prapa objektit të postës.

2.1.1.4 Rehabilitimi, revitalizimi, asfaltimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale. Asfaltimi i rrugëve të pashtruara (85km) deri në vitin 2025-2026

2.1.1.5 Përfundimi i trotuareve nëpër të gjitha institucionet komunale (shkolla, ambulanta dhe institucione publike) deri në vitin 2026

2.1.1.6 Instalimi i trupave ndriçues së paku 60 km, deri në vitin 2025-2026

2.1.1.7 Rritja e kapacitetit për furnizim me ujë të pijshëm dhe ruajtja e kualitetit te ujit të pijshëm. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatra, planifikohet që deri në vitin 2025-2026 të bëhet në të gjitha fshatrat e Komunës tonë

2.1.1.8 Përfundimi i kanalizimeve të lagjeve deri në vitin 2026

2.1.1.9 Studimi i fizibilitetit dhe hartimi i projektit për trajtimin e ujërave të zeza

2.1.1.10 Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza

2.1.1.11 Avancimi i sistemit për trajtimin e mbeturinave të ngurta. Inicimi dhe zhvillimi i idesë për themelimin e Kompanisë Komunale për trajtimin e mbeturinave

2.1.1.12 Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve, veprimtarive dhe aksioneve me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe sensibilizimit të qytetarëve për rëndësinë e mirëmbajtjes së hapësirave dhe ruajtjen e ambientit jetësor

**2.2 Zhvillimi, avancimi dhe modernizimi i sistemit shëndetësor**

*2.2.1 Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve shëndetësore, trajnimi I stafit shëndetësor dhe zgjerimit i infrastrukturës shëndetësore në QKMF, AMF dhe punkte*

2.2.1.1 Digjitalizimi i procesit të punës dhe çasja në sistemin shëndetësor për secilin qytetar.

2.2.1.2 Edukimi dhe trajnimi i vazhdueshëm i personelit shëndetësor

2.2.1.3 Furnizimi me material mjekësor, aparatura dhe pajisje të avancuara për diagnostikimin e sëmundjeve si dhe aplikimi i teknologjive modern mjekësore

2.2.1.4 Furnizimi i vazhdueshëm dhe i mjaftueshëm me barna nga lista esenciale dhe medikamente të domosdoshme mjekësore

2.2.1.5 Zgjerimi i rrjetit të mbrojtjes primare shëndetësore dhe shtimi i shërbimeve shëndetësore nëpërmjet partneritetit QKMF - Karitas Kosova konform nevojave për ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore

2.2.1.6 Themelimi i ekipeve permanente për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në shtëpi për personat me invaliditet dhe persona të palëvizshëm

2.2.1.7 Monitorimi i vazhdueshëm dhe standardizimi i kritereve për zhvillimin e shërbimeve të ordinancave private shëndetësore

2.2.1.8 Organizimi i aktiviteteve dhe veprimtarive të edukimit shëndetësor me grupe të ndryshme të interesit

**2.3. Avancimi i kushteve në ofrimin e shërbimeve sociale**

*2.3.1 Përmirësimi i kushteve dhe ngritja e kapaciteteve për realizimin e shërbimeve sociale*

2.3.1.1 Rivitalizimi i objektit dhe zgjerimi i hapësirës punuese për punët specifike

2.3.1.2 Avancimi i kushteve të sigurisë në punë

2.3.1.3 Bashkëpunimi me partner (shoqata, asociacione, iniciativë, etj) për trajtimin e kategorive të rrezikuara

2.3.1.4 Ndërtimi i objektit për strehimin e njerëzve pa përkujdesje (shtëpia e pleqve)

2.3.1.5 Menaxhimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e objektit për banim social

2.3.1.6 Realizimi programeve për trajtimin, rehabilitimin dhe risocializimin e kategorive devijonte

**2.4 Zhvillimi dhe modernizimi i sistemit arsimor në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm lokal**

*2.4.1 Zhvillimi, avancimi dhe modernizimi i sistemit arsimor*

2.4.1.1 Zgjerimi i rrjetit të institucioneve parashkollore si dhe rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore

2.4.1.2 Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës shkollore dhe përmirësimi i kushteve materialo-teknike në sistemin shkollor

2.4.1.3 Revitalizimi dhe funksionalizimi i kabineteve shkollore përmes furnizimit të vazhdueshëm me mjete të reja e bashkëkohore

2.4.1.4 Aplikimi i modeleve atraktive dhe motivuese të ligjërimit dhe adaptimi konform aftësive të nxënësve

2.4.1.5 Avancimi i shkathtësive dhe aftësive profesionale të stafit arsimor përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe implementimi i programeve të avancuara arsimore

2.4.1.6 Stimulimi dhe aplikimi i koordinuar i programeve për këshillim dhe zhvillim të karrierës

2.4.1.7 Realizimi i projekteve dhe programeve arsimore të veçanta për fëmijët me invaliditet dhe me pengesa në zhvillim

2.4.1.8 Krijimi i kushteve për zhvillimin e arsimit digjital

2.4.1.9 Harmonizimi i politikave dhe koordinimi ndër institucional me qëllim të rritjes së efikasitetit të sistemit arsimor dhe ngritjes së cilësisë së procesit mësimor

2.4.1.10 Monitorimi dhe vlerësimi kontinual i cilësisë së procesit mësimor

2.4.1.11 Krijimi dhe funksionalizimi i minibibliotekave shkollore nëpër objektet arsimore

2.4.1.12 Profilizimi i sistemit arsimor konform nevojave të ekonomisë dhe zhvillimit të përgjithshëm shoqëror

**2.5 Zhvillimi dhe afirmimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe fuqizimi i rolit të rinisë dhe të aktiviteteve sportive**

*2.5.1 Ruajtja, kultivimi, eksplorimi, promovimi dhe zhvillimi i vlerave kulturore të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore*

2.5.1.1 Mirëmbajtja dhe pajisja e Muzeut Komunal me artefakte

2.5.1.2 Krijimi i hartës së trashëgimisë kulturore të Vitisë
2.5.1.3 Restaurimi, mirëmbajtja dhe mbrojtja e objekteve me vlerë të trashëgimisë kulturo-historike
2.5.1.4 Ndërtimi i infrastrukturës te objektet dhe monumentet e trashëgimisë kulturo-historike
2.5.1.5 Atele për punime promovuese artizanale të pikturës, skulpturës në fushën e trashëgimisë kulturore
2.5.1.6 Rivitalizimi dhe pajisja e kinosallës me teknologji të sofistikuar
2.5.1.7 Organizimi i aktiviteteve dhe veprimtarive me qëllim të afirmimit të vlerave kulturore
2.5.1.8 Zgjerimi i rrjetit, rritja e fondit të librave dhe digjitalizimi i bibliotekave publike

**2.5.2 Ngritja e kapaciteteve dhe aktiviteteve në infrastrukturën sportive, rekreacionit, zhvillimit dhe promovimin e disiplinave sportive**

2.5.2.1 Përfundimi dhe funksionalizimi i palestrës sportive
2.5.2.2 Ndërtimi, zgjerimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës sportive
2.5.2.3 Ndërtimi i shtigjeve për ecje rekreative dhe shtigjeve për motokros dhe çikleta
2.5.2.4 Organizimi i aktiviteteve dhe manifestimeve sportive tradicionale në futboll/futsall
2.5.2.5 Zhvillimi, mbështetja e sporteve dhe sportistëve elitarë (reprezentuesve)
2.5.2.6 Kampingjet sportive me grupmoshat e reja
2.5.2.7 Mbështetja dhe zhvillimi disiplinave sporteve, si: atletikë, volejboll, hendboll, not, skijim etj

**2.5.3 Rritja e pjesëmarrjes aktive dhe fuqizimi i rolit të rinisë në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror**

2.5.3.1 Subvencionimi i entiteteve publike, aktiviteteve rinore, projekteve dhe nismave për aktivizimin rinor komunal
2.5.3.2 Koordinimi i qendrave rinore për shërbime dhe aktivitete sociale të të rinjve
2.5.3.3 Promovimi dhe zhvillimi i vullnetarizmit
2.5.3.4 Zhvillimi i edukimit jo formal të të rinjve për tregun e punës
2.5.3.5 Planifikimi i vikend zonave rekreative në Komunën e Vitisë
2.5.3.6 Organizimi i kampingjeve, mbrëmjeve rinore dhe vizitave studimore
2.5.3.7 Organizimi i aktiviteteve dhe veprimtarive me qëllim të sensibilizimit dhe edukimit të të rinjve për mbrojtje nga dukurit devijonte

**3. MENAXHIM I QËNDRUESHËM:** *Përmirësim dhe avancim i vazhdueshëm i menaxhimit financiar dhe resurseve njerëzore, duke marr si model praktika ndërkombëtare dhe duke i aplikuar në qeverisjen lokale*

3.1 Ofrimi dhe funksionalizimi efikas, efektiv dhe transparente Administratës komunale dhe shërbimeve publike që siguron dhe garanton qasje të barabartë dhe të drejtë për të gjithë qytetarët.

3.1.1 Ngritja e kapaciteteve menaxhuese, zhvillimi dhe avancimi i kualitetit të shërbimeve të administratës komunale
3.1.1.1 Trajnimi i vazhdueshëm i stafit përmes programeve për ngritje profesionale
3.1.1.2 Inicimi dhe zhvillimi i programeve për rritjen e dijes dhe shkathtësive praktike për aplikim te donatorët për realizimin e projekteve
3.1.1.3 Zhvillimi i sistemit të motivimit të stafit të administratës, përmes avancimit të bazuar në performancën e punës

3.1.1.4 Instalimi i procedurave dhe normativave për evaluimin e vazhdueshëm të punës dhe angazhimit të stafit të administratës komunale, publikimi i informatave institucionale në sistemin informues lokal dhe rrjeteve sociale
3.1.1.5 Fuqizimi i standardeve, ngritja e nivelit të përgjegjësisë dhe promovimi i kodit etik në punën e administratës komunale
3.1.1.6 Ngritja e përgjegjësisë dhe fuqizimi i standardeve të punës në menaxhimin efikas dhe efektiv të buxhetit komunal
3.1.1.7 Digjitalizimi i shërbimeve ndaj qytetarëve, instalimi i E-qeverisjes

**3.2 Sigurimi, garantimi i qasjes dhe trajtimit të barabartë dhe të drejtë të qytetarëve**
3.2.1. Komunikimi transparent midis komunës dhe qytetarëve
3.2.1.1Krijimi dhe instalimi i modeleve për informimin e qytetarëve
3.2.1.2 Funksionalizimi i komunikimit me qytetar nëpërmjet web faqes komunale dhe rrjeteve sociale
3.2.1.3 Komunikimi aktiv, i hapur dhe i vazhdueshëm i qeverisjes komunale me qytetarët
3.2.1.4 Zhvillimi i mekanizmave dhe instalimi i procedurave që mundësojnë, promovojnë dhe afirmojnë barazinë gjinore
3.2.1.5 Matja e përshtypjeve të qytetarëve lidhur me shërbimin administrativ lokal

## Administrimi, Monitorimi dhe Evaluimi i Strategjisë

Faza finale e realizimit të Strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm lokal është implementimi i saj, andaj është e domosdoshme që të definohet procesi i implementimit të strategjisë.

Pjesë integrale të planifikimit strategjik janë edhe aktivitetet në kuadër të sistemit të administrimit dhe të monitorimit. Dinamika, niveli dhe mënyra e realizimit të objektivave të përcaktuar është në varësi të drejtpërdrejtë nga shkalla e zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe nga aftësitë menaxheriale. Andaj, për realizimin e procesit të implementimit të strategjisë është e nevojshme dhe e domosdoshme të dizajnohet struktura organizative dhe të ngritën mekanizmat që do të administrojnë këtë proces përmes monitorimit dhe evoluimit. Hapi i parë dhe më i rëndësishëm është që, drejtoritë komunale të hartojnë planet operative të punës të bazuara në objektivat e kësaj Strategjie. Gjithashtu për procesin e implementimit të Strategjisë është me rëndësi ndarja e përgjegjësive që do të rriste efikasitetin e realizimit si dhe definimi i parametrave të matshëm të objektivave që do të mundësonte përcjelljen e progresit të realizimit të strategjisë.

Për administrimin e mirë të procesit të monitorimit, evaluimit dhe koordinimin sa më efektiv të hapave dhe veprimeve është e domosdoshme të formohet një ekip koordinues i cili do të menaxhonte këtë proces. Detyrë e këtij ekipi është monitorimi i vazhdueshëm i realizimit të strategjisë si tërësi dhe secilit projekt veç e veç dhe koordinimi i punës të të gjithë akterëve pjesëmarrës dhe aktiviteteve në të gjitha fazat e realizimit, prej inicimit, azhurnimit deri në përfundimin e projekteve të strategjisë. Ky ekip duhet të koordinojë dhe harmonizoje aktivitetet dhe veprimet me sektorin për zhvillim ekonomik.

Sistemi i administrimit duhet të përfshijë definimin e bartësve dhe përgjegjësve për implementimin e aktiviteteve dhe realizimin e projekteve të parapara. Shkalla e implementimit të Strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm duhet të monitorohet dhe vlerësohet në kontinuitet përmes analizës dhe vlerësimit periodik te fazave të realizimit të objektivave të këtij dokumenti strategjik. Të gjitha këto

veprime dhe aktivitete duhet të pasqyrohen në raporte periodike që duhet t'i dorëzohen ekzekutivit dhe në baza vjetore Kuvendit Komunal. Ekipi koordinues është përgjegjës për administrimin e procesit të implementimit, harmonizimin dhe integrimin e strategjisë për zhvillim të qëndrueshëm dhe planit operativ.

Administrimi i realizimit të strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm lokal përfshin:
Aktivitetet për vlerësimin e realizimit të planit veprues; Aktivitetet e vazhdueshëm për grumbullimin e të dhënave relevante për nevojat e monitorimit të indikatorëve të procesit; Hartimin e propozimeve për korrektimin dhe modifikimin e nevojshëm të masave, veprimeve dhe objektivave; Hartimin e raporteve dhe raportimin vjetor para Kuvendit.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për realizimin e Strategjisë për zhvillim të qëndrueshëm lokal, kryetari i Komunës, në afat prej 60 ditësh nga dita e miratimit të Strategjisë emëron koordinatorin komunal, i cili është përgjegjës për udhëheqjen dhe administrimin e procesit të implementimit të kësaj Strategjie, dhe i cili njëkohësisht: Menaxhon me ekipin koordinues; Organizon aktivitetetet e evaluimit; Bashkë me ekipin analizon, vlerëson mundësitë e realizimit të projekteve dhe siguron ofrimin e mbështetjes së nevojshme; Grumbullon, analizon dhe sistemon të dhënat dhe shënimet për monitoring; Shqyrton dhe rekomandon mundësitë dhe mënyrat tjera të financimit; Bashkëpunon me të gjithë akterët e involvuar në proces dhe harmonizon dhe operacionalizon veprimet dhe masat e nevojshme për realizimin e planit veprues; Harton raportin vjetor të implementimit dhe jep rekomandimet e nevojshme.

Shtojca: Paraqitja tabelare e objektivave dhe aktiviteteve

| Plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **1. Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik:** Forcimi i ekonomisë komunale, nxitja e zhvillimit ekonomik | | | | |
| **Objektivi specifik** | **Indikatorët (treguesit)** | | | **Ba** |
| **1.1Krijimi i ambientit atraktiv për investime** | 1.1.1 Investime infrastrukturore në Zonën Ekonomike Komunale, funksionalizimi dhe zgjerimi deri në vitin 2025 me 1100 të punësuar brenda 4 viteve. | | | 80% |
| **Aktiviteti** | **Afati i zbatimit** | **Kostoja totale** | **Burimi i financimit** | **Institucio udhëheqë** |
| 1.1.1.1 Përfundimi në tërësi i infrastrukturës dhe ndarja e parcelave në bazë të raportit të fizibilitetit | 2023 | 35.000,00 € | BK | Komuna |
| 1.1.1.2 Thirrje publike për dhënien në shfrytëzim të parcelave sipas kritereve të përcaktuar në thirrjen publike | 2024 | - | BK | Komuna |
| 1.1.1.3 Studimi i fizibilitetit për zgjerimin e Zonës Ekonomike Komunale për 8.5 hektar. | 2024 | 26.000,00 € | BK | Komuna |
| 1.1.1.4 Ndërtimi i infrastrukturër bazike dhe krijimi i kushteve për aktivizimin e zonave të reja biznesore, si dhe zgjerimi i zonës ekonomike ekzistuese . | 2025 | 1.490.000,00 € | BK | Komuna |
| **1.2 Nxitja e ndërmarrësisë së re (biznese të reja startup)** | 1.2.1 Stimulimi i zhvillimit ekonomik përmes investimeve të huaja dhe vendore | | | |
| 1.2.1.1 Krijimi i hartës komunale për investime (Oferta për investitor potencial) | 2023 | - | BK | Komuna |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.2.1.2 Ofrimi i konsulencave, këshillime në vazhdimësi për biznese. | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | SZHE, Zyra për Investime Komunale (ZIK) |
| 1.2.1.3 Krijimi i kushteve të favorshme për investitor (rregullimi i shpejt i dokumenteve regjistruese, vazhdimi i lirimit nga taksat). | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | Zyra për Regjistrimin e Bizneseve (ZRB), KK |
| 1.2.1.4 Renovimi i objektit për inkubator biznesi. | 2022-2023 | 494.253,00 € | MZHR,BK | Komuna | |
| 1.2.1.5 Krijimi i inkubatorëve biznesor (përgatitja e trupave profesionale për hapjen e bizneseve dhe dhënia e grandeve për startup biznese). | E vazhdueshme | | BK | Komuna | DFEZH, OJQ dhe asociacionet biznesore |
| 1.2.1.6 Bashkëpunimi DZHE-DKA, në mënyrë periodike të kryejnë analizën dhe vlerësimin e nevojave të tregut dhe zhvillimin e programeve me qëllim të avansimit të aftësive dhe shkathtësive profesionale. | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | SZHE, DFEZH, DKA |
| 1.2.1.7 Planifikojmë hapjen e 450 bizneseve të reja (të vogla dhe të mesme) dhe punësimi i 2500 punëtorëve . | 2025 | - | BK | Komuna | SZHE, ZIK DFEZH, MFPT, Ministria e Industrisë, Nërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), OJQ-të dhe faktorët tjerë ndikues. |
| 1.3 **Rritja e kapaciteteve të ndërmarrjeve ekzistuese** | **1.3.1 Rritja e prodhimit lokal** | | | | **2022-2025** |
| 1.3.1.1 Dhënia e grandeve në partneritet me Qeverinë dhe OJQ-të vendore dhe | E vazhdueshme | | BK | Komuna | Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| ndërkombëtare për pika grumbulluese në sektorin e bujqësisë. | | | | | Zhvillim Rural (DBPZHR) |
| 1.3.1.2 Gjetja e tregjeve të jashtme, bashkpunimi biznese-oda ekonomike-institucione. | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | Bizneset, SZHE, MINT, Odat Ekonomike, ME dhe të tjerë. |
| 1.3.1.3 Mbajtja e një konference investive me investues potencial në Komunën e Vitisë (identifikimi i investitorëve potencial). | 2024 | 2000 € | BK | Komuna | SZHE, ZPI, DFEZH, MINT, bizneset vendore dhe ndërkombëtare dhe faktorët tjerë ndikues |
| **1.4 Promovimi i Partneritetit Publiko Private (PPP)** | **1.4.1 Nxitja e investimeve përmes PPP-së** | | | | 2022-2025 |
| 1.4.1.1 Bashkëpunimi ndërinstitucional (qendror dhe lokal) | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DFEZH, SZHE, ministritë përkatëse |
| 1.4.1.1 Themelimi dhe funksionalizimi i Grupit Punues (GP) për PPP-në. | 2023 | - | BK | Komuna | SZHE, Bordi i Drejtoreve |
| 1.4.1.2 Krijimi i Listës prioritare të projekteve për PPP. | 2023 | - | BK | Komuna | SZHE, DFEZH, DSHP |
| 1.4.1.3 Përzgjedhja e katër projekteve potenciale për PPP-në | 2023/24 | - | BK | Komuna | DFEZH, Komisioni ndërministror |
| 1.4.1.4 Sigurimi i fondeve për studimin e fizibilitetit për projektet e PPP-së | 2023/24 | 50.000,00 € | BK | Komuna | DFEZH, DSHPE, MINT dhe donator tjerë |
| 1.4.1.5 Hartimi dhe realizimi i së paku 2 projekteve të PPP-së. | 2025 | 400.000,00 € | BK.Partneri privat | Komuna | DFEZH, DSHPE, MINT dhe donator tjerë |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **1.5 Zhvillimi i turizmit lokal** | 1.5.1 Zhvillimi i turizmit përmes konceptit të bazuar në resurset natyrore dhe trashëgimia kulturo-historike | | | | |
| 1.5.1.1 Themelimi i zyres informuese | 2023 | 8,400€ | BK | Komuna | **DKRS**, DB, SZHE, MINT, MKRS |
| 1.5.1.2 Shënjimi i objekteve dhe zonave të kategorizuara me vlerë kulturo-historike dhe vendosja e tabelave orientuese. | 2023/2024 | 5,200€ | BK | Komuna | DKRS, DSHPE |
| 1.5.1.3 Restaurimi, konservimi dhe mirëmbajtja e objekteve me vlerë të trashëgimisë kulturo-historike. | 2023/2025 | 160.000,00 € | BK | Komuna | MKRS, **DKRS**, DSHPE dhe OJQ-të |
| 1.5.1.4 Përcaktimi i zonave me potencial për zhvillimin e turizmit natyror. | 2023 | - | BK | Komuna | SZHE, DKPGJ, DUPMM, |
| 1.5.1.5 Ndërtimi i infrastrukturës dhe krijimi i kushteve për zhvillimin e turizmit. | 2024/2025 | 600.000,00 | BK | Komuna | |
| 1.5.1.6 Zhvillimi i rrjetit të veprimtarive shërbyese dhe ngritja e kapaciteteve akomoduese nëpër zonat me potencial për zhvillimin e turizmit (bujtina, restorante, hotele. | E vazhdueshme | | BK | Komuna | Investitorët dhe donatorët |
| 1.5.1.7 Organizimi vjetor i panairit bujqësor me qëllim të prezentimit dhe promovimit të resurseve dhe produkteve vendore në funksion të zhvillimit të turizmit lokal si dhe organizimi i aktiviteteve dhe veprimtarive kulturore me qëllim të prezantimit dhe afirmimit të vlerave të trashëgimisë kulturore. | E vazhdueshme | 16,800€ | BK | Komuna | SZHE, DBPZHR, DKRS, prodhuesit dhe donatorët |
| **1.6 Ndërtimi i sektorit efikas dhe të qëndrueshëm bujqësor** | **1.6.1 Ngritja e sistemit bujqësor i cili me produktivitetin dhe prodhimet e veta mund** | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **të përballoj konkurrencën në treg dhe si i tillë të siguroj të ardhura stabile dhe të gjeneroj punësim** | | | | |
| 1.6.1.1 Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore për bujqësi, mbrojtja dhe ruajtja e tokës bujqësore, rritja e sipërfaqeve bujqësore dhe garantimi i çasjes në tokën bujqësore. | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DBPZHR, DKPGJ |
| 1.6.1.2 Përkrahja dhe fuqizimi i prodhimtarisë primare. Subvencionimi i prodhimtarisë primare | E vazhdueshme | **683.400,00 €** | MBPZHR | Komuna | MBPZHR, DBPZHR |
| 1.6.1.3 Subvencionimi për perim kulturë | E vazhdueshme | **89.700,00 €** | MBPZHR | Komuna | MBPZHR, DBPZHR |
| 1.6.1.4 Subvencionimi për pemë | E vazhdueshme | **74.200,00 €** | MBPZHR | Komuna | MBPZHR, DBPZHR |
| 1.6.1.5 Subvencionimi pr Blegtori | E vazhdueshme | **563.000,00 €** | MBPZHR | Komuna | MBPZHR, DBPZHR |
| 1.6.1.6 Subvencionet e komunës për sektorin e Bujqësisë | E vazhdueshme | **350.000,00 €** | BK | Komuna | KK,DBPZHR |
| 1.6.1.3 Zhvillimi, avancimi dhe fuqizimi i prodhimtarisë bujqësore (rritja e kapaciteteve dhe aftësive konkurruese në treg). | E vazhdueshme | | BK | Komuna | MBPZHR, DBPZHR OJQ dhe prodhuesit bujqësor |
| 1.6.1.4 Modernizimi i Bujqësisë, zhvillimi dhe avansimi i aftësive dhe shkathtësive për aplikimin e njohurive, inovacioneve dhe teknologjive të reja. | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | MBPZHR, DBPZHR OJQ dhe prodhuesit bujqësor |
| 1.6.1.5 Zhvillimi dhe avancimi i kapaciteteve për përpunimin e prodhimeve bujqësore | 2024/2025 | - | BK | Komuna | |
| 1.6.1.6 Zhvillimi i sektorit të blegtorisë dhe menaxhimi efikas i pyjeve dhe kullosave | E vazhdueshme | | BK | Komuna | DBPZHR, MBPZHR dhe farmerët |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| (zhvillimi dhe avancimi i sektorit të blegtorisë) | | | | | |
| 1.6.1.7 Kujdesi, mirëmbajtja e pyjeve e kullosave dhe menaxhimi efektiv i tyre | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DBPZHR, Agjensioni i Pyjeve (AP), MBPZHR |
| 1.6.1.8 Zhvillimi rural dhe mbrojtja e ambientit (zhvillimi i balancuar i zonave rurale) | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DBPZHR, DSHPE, MZHR, MBPZHR, MMPHI |
| 1.6.1.9 Fuqizimi i normave dhe standardeve për mbrojtjen e mjedisit | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DSHPE, DI, MMPHI |
| 1.6.1.10 Shfrytëzimi i resursit ujor nga Morava me prrockat rreth saj për zhvillimin e bujqësisë (rregullimi i infrastrukturës ujore). | 2023/2025 | | BK | Komuna | DBPZHR, MBPZHR, MMPHI |
| 1.6.1.11 Ndërtimi i sistemit te ujitjes | 2023-2025 | | | Komuna | DBPZHR, MBPZHR, MMPHI |
| **2. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM SOCIAL:** *Sigurimi dhe garantimi i qasjes së barabartë në institucionet komunale për të gjithë qytetarët. Avancimi dhe modernizimi i sistemit shëndetësor, arsimor dhe shërbimeve sociale.* | | | | | |
| **2.1 2.1 Përmirësimi i kushteve dhe ngritja e kualitetit të ambientit jetësor** | 2.1.1 Infrastrukturë moderne të jetës (asfaltim i rrugëve, trotuareve, ndriçimi publik, ujësjellësi, kanalizimi etj) | | | | |
| 2.1.1.1 Asfaltimi i rrugës në Stubëll e Epërme, rruga prej "Anton Qeta" deri te rruga "Sejdiu",faza 2 | 2022-2023 | 300.000,00 € | MMPHI | Komuna | |
| 2.1.1.2 Asfaltimi i rrugës Mjak-Debelldeh | 2022-2024 | 463.890,00 € | MMPHI | | |
| 2.1.1.3 Rregullimi i sheshit "Calmy Rey"; rruga "Kongresi i Manastirit"; rregullimi i hapësirës prapa objektit të postës. | 2022-2023 | 770.000,00 € | MAPL | Komuna | MAPL. Helvetas Swiss Intercooperation, Komuna e Vitisë |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.1.4 Asfaltimi i rrugëve të pashtruara (85km) | 2023-2025 | 1.380.000,00 € | BK | Komuna | ZP, DSHPE, faktor tjerë |
| 2.1.1.5 Përfundimi i trotuareve nëpër të gjitha institucionet komunale (shkolla, ambulanta dhe institucione publike) deri në vitin 2025. | | | | | |
| 2.1.1.6 Instalimi i trupave ndiçues së paku 60 km | 2023-2025 | 1.600.000,00 € | BK | Komuna | ZP, DSHPE, faktor tjerë |
| 2.1.1.7 Rritja e kapacitetit për furnizim me ujë të pijshëm dhe ruajtja e kualitetit te ujit të pijshëm. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellsit në fshatra, planifikohet që deri në vitin 2025-2026 të bëhet në të gjitha fshtart e Komunës tonë. | 2023-2025 | 720.000,00 € | BK | Komuna | ZP, DSHPE, faktor tjerë |
| 2.1.1.8 Përfundimi i kanalizimeve lagjore | 2023-2025 | 480.000,00 € | BK | **Komuna** | ZP, DSHPE, faktor tjerë |
| 2.1.1.9 Studimi i fizibilitetit dhe hartimi i projektit për trajtimin e ujërave të zeza | 2023-2024 | 65.000,00 € | BK | **Komuna** | ZP, DSHPE, Qeveri, OJQ dhe faktor te tjere |
| 2.1.1.10 Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza , kolektorëve për ujërat fekale dhe atmosferike , si dhe infrastrukturës përcjellëse . | 2025 | 14.250.000,00 € | BK | **Komuna** | ZP, DSHPE, Qeveri, OJQ dhe faktor te tjere |
| 2.1.1.11 Avancimi i sitemit për trajtimin e mbeturinave të ngurta. Inicimi dhe zhvillimi i idesë për themelimin e Kompanisë Komunale për trajtimin e mbeturinave. | 2023-2025 | - | BK | **Komuna** | ZP, DSHPE, faktor tjerë |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.1.12Organizimi i veprimtarive, aktiviteteve dhe aksioneve me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe senzibilizimit të qytetarëve për rëndësinë e mirëmbajtjes së hapësirave dhe ruajtjen e ambientit jetësor. | | 2000,00 € | BK | **Komuna** | OJQ,DSHPE |
| **2.2 Zhvillimi, avancimi dhe modernizimi i sistemit shëndetësor** | 2.2.1 Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve shëndetësore, trajnimi i stafit shëndetësor dhe zgjerimit i infrastrukturës shëndetësore në QKMF, AMF dhe punkte. | | | | |
| 2.2.1.1 Digjitalizimi i procesit të punës, çasja në sistemin shëndetësor për secilin qytetar dhe të hyrave financiare | 2023 | 20.000,00 € | BK | Komuna | DSHMS, MSH |
| 2.2.1.2 Edukimi dhe trajnimi i vazhdueshëm I personelit shëndetësor. | E vazhdueshme | - | BK | **Komuna** | DSHMS, MSH |
| 2.2.1.3 Furnizimi me material mjekësor, aparatura dhe paisje të avancuara për diagnostifikimin e sëmundjeve si dhe aplikimi i teknologjive modern mjekësore. | E vazhdueshme | 60.000,00 € | BK | **Komuna** | DSHMS, MSH, donatorët |
| 2.2.1.4 Furnizimi i vazhdueshëm dhe i mjaftueshëm me barëra nga lista esenciale dhe medikamente të domosdoshme mjekësore | E vazhdueshme | | MSH | **Komuna** | MSH |
| 2.2.1.5 Zgjerimi i rrjetit të Mbrojtjes primare shëndetësore dhe shtimi i shërbimeve shëndetësore nëpërmjet partneritetit QKMF - Karitas Kosova konform nevojave për ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore. | E vazhdueshme | 5.000,00 € | BK | **Komuna** | DSHMS, MSH, OJQ, donatorët |
| 2.2.1.6 Themelimi i ekipeve permanente për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në shtëpi | E vazhdueshme | - | BK | **Komuna** | DSHMS, QKMF, OJQ |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| për personat me invaliditet dhe persona të palëvizshëm. | | | | | |
| 2.2.1.7 Monitorimi i vazhdueshëm dhe standardizimi i kritereve për zhvillimin e shërbimeve dhe ordinancave private shëndetësore. | E vazhdueshme | - | BK | **Komuna** | DSHMS, MSH |
| 2.2.1.8 Organizimi i aktiviteteve dhe veprimtarive të edukimit shëndetësor me grupe të ndryshme të interest. | E vazhdueshme | 2.000,00 | BK | **Komuna** | DSHMS, QKMF, DKA, OJQ, PK |
| 2.3. **Avancimi i kushteve në ofrimin e shërbimeve sociale** | 2.3.1 Përmirësimi i kushteve dhe ngritja e kapaciteteve për realizimin e shërbimeve sociale | | | | |
| 2.3.1.1 Rivitalizimi i objektit dhe zgjerimi i hapësires punuese për punët specifike, | 2024/2025 | 240.000,00 € | BK | Komuna | DSHMS, ZP ministria përkatëse donatorët |
| 2.3.1.2 Avancimi i kushteve të sigurisë në punë. | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DSHMS |
| 2.3.1.3 Bashkëpunimi me partner (shoqata, asociacione, inciative, etj) për trajtimin e kategorive të rrezikuara. | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DSHMS, ministritë përkatëse, OJQ |
| 2.3.1.4 Ndërtimi i objektit për strehimin e njerëzve pa përkujdesje (shtëpia e pleqëve). | 2024/2025 | 440.000,00 € | BK | Komuna | DSHMS, ministritë përkatëse, OJQ |
| 2.3.1.5 Menaxhimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e objektit per banim social. | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DSHMS, QPS DSHPE |
| 2.3.1.6 Realizimi programeve për trajtimin, rehabilitimin dhe resocializimin e kategorive devijante. | E vazhdueshme | 2.000,00 € | BK | Komuna | DSHMS, QPS DSHPE |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.4 Zhvillimi dhe modernizimi i sistemit arsimor në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm lokal | 2.4.1 Zhvillimi, avancimi dhe modernizimi I sistemit arsimor | | | | |
| 2.4.1.1 Zgjerimi i rrjetit të institucioneve parashkollore si dhe rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore. | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DKA, MASHTI OJQ |
| 2.4.1.2 Përmirësimi i vazhdueshëm I infrastrukturës shkollore dhe përmirësimi I kushteve matreialo-teknike në sistemin shkollor | E vazhdueshme | 160.000,00 € | BK | Komuna | DKA, MASHTI OJQ |
| 2.4.1.3 Revitalizimi dhe funksionalizimi I kabineteve shkollore përmes furnizimit të vazhdueshëm me mjete të reja e bashkëkohore | E vazhdueshme | 60.000,00 € | BK | Komuna | DKA, MASHTI OJQ |
| 2.4.1.4 Aplikimi i modeleve atraktive dhe motivuese të ligjërimit dhe adaptimi konform aftësive të nxënësve | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DKA, MASHTI |
| 2.4.1.5 Avancimi i shkathtësive dhe aftësive profesionale të stafit arsimor përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe implementimi I programeve të avancuara arsimore | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DKA, MASHTI OJQ |
| 2.4.1.6 Stimulimi dhe aplikimi i koordinuar i programeve për këshillimi dhe zhvillim te karrierës | E vazhdueshme | - | | Komuna | DKA, MASHTI OJQ |
| 2.4.1.7 Realizimi i projekteve dhe programeve arsimore të veçanta për fëmijët me invaliditet dhe me pengesa në zhvillim | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DKA, MASHTI OJQ |
| 2.4.1.8 Krijimi i kushteve për zhvillimin e arsimit digjital | 2024/2025 | 40.000,00 € | BK | Komuna | DKA, MASHTI OJQ |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.4.1.9 Harmonizimi i politikave dhe koordinimi ndërinstitucional me qëllim të rritjes së efikasitetit të sistemit arsimor dhe ngritjes së cilësisë së procesit mësimor. | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DKA, MASHTI |
| 2.4.1.10 Monitorimi dhe vlerësimi kontinual i cilësisë së procesit mësimor | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DKA, MASHTI |
| 2.4.1.11 Krijimi dhe funksionalizimi i minibibliotekave shkollore nëpër objektet arsimore. | E vazhdueshme | 35,000€ | BK | Komuna | DKA, DKRS, OJQ |
| 2.4.1.12 Profilizimi i sistemit arsimor konform nevojave të ekonomisë dhe zhvillimit të përgjithshëm shoqëror | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | DKA, DFEZH SZHE |
| **2.5 Zhvillimi dhe afirmimi i vlerave të trashigimisë kulturore dhe fuqizimi i rolit të rinisë dhe të aktiviteteve sportive** | 2.5.1 Ruajtja, kultivimi, eksplorimi, promovimi dhe zhvillimi I vlerave kulturore të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore. | | | | |
| 2.5.1.1 Mirëmbajtja dhe pajisja e Muzeut Komunal me artefakte | E vazhdueshme | 128,000€ | BK | Komuna | DKRS, MKRS, OJQ donator |
| 2.5.1.2 Krijimi i hartës së trashëgimisë kulturore të Vitisë | 2024 | 8,900€ | BK | Komuna | DKRS, MKRS, OJQ |
| 2.5.1.3 Restaurimi, mirëmbajtja dhe mbrojtja e objekteve me vlerë të trashëgimisë kulturo-historike. | 2024 | 65,000€ | BK | Komuna | DKRS, MKRS, OJQ |
| 2.5.1.4. Atele për punime promovuese artizanale të pikturës, skulpturës në fushën e trashëgimisë kulturore. | 2024 | 30.000,00 | BK | Komuna | DKRS, MKRS, OJQ artistët |
| 2.5.1.5Rivitalizimi dhe pajisja e kinosallës me teknologji të sofistikuar. | E vazhdueshme | 8,200€ | BK | Komuna | DKRS, OJQ, donato |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.5.1.6 Organizimi i aktiviteteve dhe veprimtarive me qëllim të afirmimit të vlerave kulturore. | E vazhdueshme | 4,800€ | BK | Komuna | DKRS, OJQ, donato |
| 2.5.1.7 Zgjerimi i rrjetit, rritja e fondit të librave dhe digjitalizimi i bibliotekave publike. | E vazhdueshme | 12,800€ | BK | Komuna | DKRS, DKA MKRS, OJQ, donatc |
| | 2.5.2 Ngritja e kapaciteteve dhe aktiviteteve në infrastrukturën sportive, rekreacionit, zhvillimit dhe promovimin e disiplinave sportive | | | | |
| 2.5.2.1 Përfundimi dhe funksionalizimi i palestrës sportive. | 2024 | 250.000,00 € | BK | Komuna | DFEZH, DKRS MKRS |
| 2.5.2.2 Ndërtimi, zgjerimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës sportive. | E vazhdueshme | 1.070.000,00 € | BK | Komuna | DFEZH, DSHPE |
| 2.5.2.3 Ndërtimi i shtigjeve për ecje rekreative dhe shtigjeve për motokros dhe çikleta | 2024-2025 | 200.000,00 € | BK | Komuna | DFEZH, DSHPE |
| 2.5.2.4 Organizimi i aktiviteteve dhe manifestimeve sportive tradicionale në futboll/futsall | E vazhdueshme | 8,500 € | BK | Komuna | DKRS, donatorët |
| 2.5.2.5 Zhvillimi, mbështetja e sporteve dhe sportistëve elitarë (reprezentuesve). | E vazhdueshme | 5,800€ | BK | Komuna | DKRS, donatorët |
| 2.5.2.6 Kampingjet sportive me grupmoshat e reja | E vazhdueshme | 6,500€ | BK | Komuna | DKRS, donatorët |
| 2.5.2.7 Mbështetja dhe zhvillimi disiplinave sporteve, si: Atletikë, Volejboll, Hendboll, Not, Skijim etj. | E vazhdueshme | 4,500€ | BK | Komuna | DKRS, donatorët |
| | 2.5.3 2.5.3.Rritja e pjesëmarrjes aktive dhe fuqizimi i rolit të rinisë në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.5.3.1 Subvencionimi i entiteteve publike, aktiviteteve rinore, projekteve dhe nismave për aktivizmin rinor komunal | E vazhdueshme | 400,000€ | BK | Komuna | DKRS, donatorët |
| 2.5.3.2 Koordinimi i qendrave rinore për shërbime dhe aktivitete sociale të të rinjve | E vazhdueshme | 4,800€ | BK | Komuna | DKRS, donatorët |
| 2.5.3.3 Promovimi dhe zhvillimi i vullnetarizmit | E vazhdueshme | 5,800€ | BK | Komuna | DKRS, donatorët |
| 2.5.3.4 Zhvillimi i edukimit jo formal të të rinjeve për tregun e punës | E vazhdueshme | 8,800€ | BK | Komuna | DKRS, DKA DFEZH-SZHE, OJQ |
| 2.5.3.5 Planifikimi i vikend zonave rekreative në Komunën e Vitisë | 2024 | 150.000,00 € | BK | Komuna | DKRS, OJQ |
| 2.5.3.6 Organizimi i kampingjeve, mbrëmjeve rinore dhe vizitave studimore | E vazhdueshme | 4,800€ | BK | Komuna | DKRS, donatorët |
| 2.5.3.7 Organizimi i aktiviteteve dhe veprimtarive me qëllim të senzibilizimit dhe edukimit të të rinjve për mbrojtje nga dukurit devijonte. | E vazhdueshme | 4,800€ | BK | Komuna | DKRS, DSHMS DKA, Policia, OJQ |
| **3. Menaxhim i Qëndrueshëm:** Përmirësim dhe avansim i vazhdueshëm i menaxhimit financiar dhe resuseve njerëzore, duke marr si model praktika ndërkombëtare dhe duke i aplikuar në qeverisjen lokale. | | | | | |
| **3.1 Ofrimi dhe funksionalizimi efikas, efektiv dhe transparente Administratës komunale dhe shërbimeve publike që** | 3.1.1 Ngritja e kapaciteteve menaxhuese, zhvillimi dhe avancimi i kualitetit të shërbimeve të administratës komunale | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **siguron dhe garanton qasje të barabartë dhe të drejtë për të gjithë qytetaret** | | | | | |
| 3.1.1.1 Trajnimi i vazhdueshëm i stafit përmes programeve për ngritje profesionale | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | NJP, drejtori përkatëse |
| 3.1.1.2 Inicmi dhe zhvillimi i programeve për rritjen e dijes dhe shkathtësive praktike për aplikim te donatorët për realizimin e projekteve | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | NJP, drejtori përkatëse |
| 3.1.1.3 Zhvillimi i sistemit të motivimit të stafit të administratës përmes avancimit të bazuar në performancën e punës | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | ZK, NJP, drejtori përkatëse |
| 3.1.1.4 Instalimi i procedurave dhe normativave për evaluimin e vazhdueshëm të punës dhe angazhimit të stafit të administratës komunalë Publikimi i informatave institucionale në sistemin informues lokal dhe rrjeteve sociale. | E vazhdueshme | 20.000,00€ | BK | Komuna | ZK, ZI, drejtori përkatëse |
| 3.1.1.5 Fuqizimi i standardeve, ngritja e nivelit të përgjegjësisë dhe promovimi i kodit etik në punën e administratës komunalë | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | ZK, drejtori përkatëse |
| 3.1.1.6 Ngritja e përgjegjësisë dhe fuqizimi i standardeve të punës në menaxhimin efikas dhe efektiv të buxhetit komunal | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | ZK, DFEZH |
| 3.1.1.7 Digjitalizimi i shërbimeve ndaj qytetarëve. instalimi i E-qeverisjes | E vazhdueshme | 40.000,00 € | BK | Komuna | DA |
| **3.2 Sigurimi, garantimi i qasjes dhe trajtimit të barabartë dhe të drejtë të qytetarëve** | 3.2.1. Komunikimi transparent midis Komunës dhe qytetarëve | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3.2.1.1Krijimi dhe instalimi i modeleve për informimin e qytetarëve | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | ZK, ZI, KK |
| 3.2.1.2 Funksionalizimi i komunikimit me qytetar nëpërmjet web faqës komunale dhe rrjeteve sociale. | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | ZK, ZI, KK |
| 3.2.1.3 Komunikimi aktiv, i hapur dhe i vazhdueshëm i qeverisjes komunale me qytetarët | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | ZK, ZI, KK |
| 3.2.1.4 Zhvillimi i mekanizmave dhe instalimi i procedurave që mundësojnë, promovojnë dhe afirmojnë barazinë gjinore | E vazhdueshme | 2.000,00 € | BK | Komuna | ZK, NJBGJ, OJQ, |
| 3.2.1.5 Matja e përshtypjeve të qytetarëve lidhur me shërbimin administrativ lokal | E vazhdueshme | - | BK | Komuna | ZI, mediat, OJQ |

## LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|---|---|
| AP | – Agjensioni i Pyjeve |
| BK | – Buxheti Komunal |
| QPS | – Qendra për Punë Sociale |
| DBPZHR | – Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural |
| DFZHE | – Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik |
| DKPGJ | – Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi |
| DI | – Drejtoria e Inspekcionit |
| DKA | – Drejtoria Komunale për Arsim |
| DKRS | – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport |
| DSHMS | – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale |
| DSHPE | – Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë |
| DUPMM | – Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit |
| KAB | – Korniza Afatmesme Buxhetore |
| KK | – Kuvendi Komunal |
| MAPL | – Ministria për Administrim të Pushtetit Lokal |
| MASHTI | – Ministria për Arsim, Shkencë, Teknologji dhe Inovacionit |
| MBZHR | - Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural |
| ME | – Ministria për Ekonomi |
| MFPT | – Ministria për Financa, Punë dhe Transfere |
| MKRS | – Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport |
| MMPHI | – Ministria për Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe infrastrukturë |
| MINT | – Ministria për Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti |
| MPMS | – Ministria për Punë dhe Mbrojtje Sociale |
| MSH | – Ministria për Shëndetësi |
| MZHR | – Ministria për Zhvillim Rajonal |
| NJBGJ | – Njësia për Barazi Gjinore |
| NJP | – Njësia për Personel |
| OJQ | – Organizatat Joqeveritare |

Viti, 2022

Kryetari i Komunës së Vitisë

Sokol Haliti

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E VITISË KRYETARI REPUBLIKA KOSOVA OPŠTINA VITINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

09-11-2022
02-035/02-1273

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 shkronja h) të Ligjit mbi vetëqeverisjn lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008, dhe 50 paragrai 1 shkronja 1, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i komunës së Vitisë propozon këtë:

# PROPOZIM VENDIM
## Për krijimin e kodeve të ri për projektet me participim

**Neni 1.**
Me këtë propozim – vendim Kryetari i komunes së Vitisë i propozon Kuvendit të komunës së Vitisë që të miraton vendimin për krijimin e kodeve të ri për projektet me participim me qytetar sipas kritereve të percaktuara për ndarjet të subvenconeve në thirrjen publike.

**Neni 2.**
Të lejohet krijimi i kodit të ri për subvencionimi e projekteve të parapara nga DBPZHR. nga kategoria e shpenzimeve subvenvione dhe transfere.

| Nr | Emri i Projektit | Shumat totale të përfituar nga operatoret | % e participimit të përfituesve | Shuma për participim/komunitetit | Shuma për participim/komuna |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Furnizim me shperndarse të plehurit artificial | 11100 euro | 20% | 2200 euro, | 8900 euro |
| 2 | Furnizim me grrebulja me kardon | 20850 euro | 20% | 5770 euro | 15080 euro |
| 3 | Furnizim me koshere me bletë | 14850 | 25% | 3712.5 euro | 11137.5 |

**Neni 3.**
Pas miratimint të këtij propozim vendimit nga Kuvendi Komunal munde të krijohet kodet e reja për projektet me participim.

**Neni 4.**
Për zbatimin e këtij propozim-vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Neni 5.**
Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në web faqen e Komunës.

Drejtori:
Naim Pira

Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

02-035/02-1282

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 6 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës,nenit 7 paragrafi 2 i Rregullore (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 18 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020, për transparencë në komuna, nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

# PROPOZIM VENDIM

**Për shpalljen në konsultim`publik të draft Rregullore për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës,**

**Neni 1**

Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të shpallë në konsultim publik draft Rregullore për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

**Neni 2**

Propozimi në konsultim publik i propozim të draft Rregullore për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, do të jepet në konsultim publik nga data 01.12.2022 deri me date 31.12.2022. Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshim apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes së debatit publik, gjithashtu në formën të shkruar munde të paraqiten gjate kohëzgjatjes së konsultimit publik në zyrën Ligjore të Komunës së Vitisë ndërtesa e Kryetarit zyra nr. 1 si dhe në forme elektronike munde të dërgohen ne emalin adresën Haxhiuu@hotmail.com, dokumenti gjendet në ueb faqen e komunës së Vitisë, kk.rks-gov.net/viti.

**Neni 3**

Debati publik do të mbahet me datën: 10.01.2023 në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë. Të bashkangjitur me këtë propozim vendim gjeni draft Rregullore për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

**Neni 4**

Të drejtë pjesëmarrje në konsultim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

**Neni 5**

Qëllimi i këtij konsultimi publik është për të krijuar opinione pozitive për draft Rregulloren për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

**Neni 6**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

PROPOZUES, KRYETARI I KOMUNËS

Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

# PROPOZIM RREGULLORE
# PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Nentor 2022

për Financat e Pushtetit Lokal,si dhe nenit 50 paragrafi 1 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës paraqet këte:

# PROPOZIM RREGULLORE
# PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1**
**Qëllimi**

Me këtë propozim Rregullore përcaktohen, kriteret kushtet dhe procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për interes publik, për peridhën më pak se një vit.

**Neni 2**
**Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga organet e komunës, personat fizik dhe juridik në territorin e Komunës së Vitisë .

**Neni 3**
**Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin, siç është përkufizuar në Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

**Neni 4**
**Parimet e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1.Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet duke u bazuar në këto parime:
**1.1. Parimi i ligjshmërisë** - nënkupton se dhënia në shfrytëzim dhe këmbimi i pronës së paluajtshme të komunës duhet të bazohen në Kushtetutë, ligj dhe aktet e tjera nënligjore;
**1.2. Parimi i efikasitetit** - nënkupton se organet e komunës zhvillojnë procedurën për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, sa më shpejtë dhe sa më pak shpenzime për komunën dhe për palët, duke siguruar edhe qëllimin e dhënies së pronës për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal;
**1.3. Parimi i trajtimit të barabartë të palëve** - nënkupton se të gjitha palët në procesin e dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, trajtohen në mënyrë të barabartë, duke shmangur çdo diskriminim ndaj palëve dhe duke vepruar në mënyrë objektive dhe të paanshme ndaj të gjithëve;

**1.4. Parimi i transparencës** - nënkupton se organet e komunës duhet të veprojnë me transparencë, të respektojnë dhe të garantojnë të drejtat e palëve për t'u informuar lidhur me procedurat, kushtet dhe ecurinë e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;
**1.5. Parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës publike të komunës** - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale është i detyruar që pronën ta shfrytëzoj në atë mënyrën që ta ruaj vlerën e saj dhe të përdorë të gjitha masat përkatëse për rritjen e kësaj vlere;
**1.6. Parimi i ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës** - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale, duhet ta shfrytëzoj pronën vetëm sipas destinimit të pronës duke

**Neni 5**
**Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit**

1. Komunat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës për me pak se një (1) vit.

2. Pronat e paluajtshme e komunës të cilat mund të jepet në shfrytëzim për më pak se një (1) vit, janë:

2.1 Hapësirat publike, (parqet, sheshet, bulevardet, panot reklamuese);

2.2 Shtëpitë e kulturës, kinematë, teatrot dhe terenet rekreative-sportive;

2.3 Hapësirat publike para lokaleve;

2.4 Lokalet në pronësi të komunës;

2.5 Hapësirat publike rreth vend punishteve.

3. Kompensimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit përcaktohet me rregullore të komunës për taksa komunale.

**Neni 6**
**Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit jepet, duke u bazuar në kriteret vijuese:

1.1 Të jetë e regjistruar si pronë e komunës në regjistrat kadastrale të pronës;
1.2 Të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta;
1.3 Të mos ketë ndonjë kontest pronësor;
1.4 Të jetë në pajtueshmëri me dokumentet e planifikimit hapësinor;
1.5 Të plotësoj kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore;
1.6 Të ketë arsyeshmërinë të interesit publik;
1.7 Të ndikojë në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë;
1.8 Të ndikojë në rritjen e vlerave e diversitetit arsimor, kulturore-sportiv e të ngjajshme.

**Neni 7**
**Procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit**

1. Prona e paluajtshme e komunës jepet në shfrytëzim për peridhën më pak se një (1) vit për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët shprehin interesim përmes një kërkese zyrtare me shkrim.
2. Kërkesa duhet t'i drejtohet organin kompetent, drejtorisë përkatëse:
   - 2.1. Për dhënien në shfrytëzim të hapsirave publike, kërkesa i drejtohet drejtorisë së Urbanizmit;
   - 2.2. Për dhënien në shfrytëzim për objektet kultorore, rinore dhe sportive, kërkesa i drejtohet drejtorisë për kulturë, rini dhe sport ;

drejtorisë përkatëse për pronë ;

2.4. Për dhënien në shfrytëzim të hapsirave publike rreth vend punishteve, kërkesa i drejtohet drejtorisë për shërbimeve publike;

3. Prona e cila jepet në shfrytëzim mbi bazën e kërkesës së aplikuesit duhet të shfrytëzohet vetëm për destinimin e kërkuar.

**Neni 8**
**Kushtet për aplikim**

1. Personat fizik dhe juridik me rastin e aplikimit për të marrë në shfrytëzim pronën e paluajsthme të komunës duhet të bashkangjesin këto dokumente:
   1.1. Formularin e plotësuar me të dhënat e kërkuara nga drejtoria përkatëse;
   1.2. Kopja e letërnjoftimit për personat fizik ;
   1.3. Certifikata e regjistrimit të biznesit për personat juridik ;
   1.4. Historiati i bisnesit që aplikon ;
   1.5. Veprimtaria që do të zhvillojë;
   1.6. Projekti ideor ;
   1.7. Vërtetimi nga komunat për përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë dhe taksave komunale;
2. Në rast se dokumentet të cilat kërkohen në apilikimin për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës nuk janë të kompletuara, kërkesa refuzohet nga ana e drejtorisë përkatëse .

**Neni 9**
**Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për Organizatat e shoqërisë civile**

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së komunës për organizatat e shoqërisë civile për periudhën më pak se një (1) vit jepet me procedura të njëjta siç është përcaktuar me këtë rregullore.
2. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për organizatat e shoqërisë civile_ jepet nga një (1) ditë deri në dhjetë (10) ditë të cilat kanë për qëllim ushtrimin e veprimtarive në kuadër të kompetencave vetanake të komunës, për promovimin e vlerave kulturore, historike, arkeologjike, sportive, rinore, arkitekturën historike, e të ngjashme.
3. Organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë për qëllim ushtrimin e aktiviteteve të cekura në paragrafin 2 të këtij neni prona e paluajtshme iu jepet në shfrytëzim vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlersues.
4. Organizatat e shoqërisë cilvile të cilat ushtrojnë veprimtarinë apo aktivitetet rehabilituese për personat me nevoja të veçanta, prona e paluajtshme e komunës mund të iu jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit, vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlersues.

**Neni 10**
**Formimi dhe përbërja e komisionit**

1. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për secilën drejtori e cila në bazë të kësaj regulloreje ka kompetencë dhe autoritet të jep në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës.
2. Komisioni do të ketë përbërje, prej tre (3) anëtarëve, ku kryesues i komisionit do të jetë zyrtari nga drejtoria së cilës i është drejtuar kërkesa për marrjen në shfrytëzim të pronë së paluajtshme të komunës, ndërsa dy anëtar mund të jenë nga drejtoritë tjera të fushave profesionale.

dhe përputhshmëri me arsyeshmërinë e kërkesës.

4. Pas shqyrtimit të kërkesës, komisioni duhet të bëjë raport përfundimtar dhe të rekomandojë për palën përfituese
5. Mandati i komisionit do te jetë dy (2) vite .

**Neni 11**
**E drejta e ankesës**

1. Pala e pakënaqur kundër procesit të vlersimit të kërkesës ka të drejtë ankese në komisionin e ankesave të komunës, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
2. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave ;
3. Përbërja e komisionit do të jetë prej pes (5) anëtar, ku njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë jurist, ndërsa të tjerët profesionist sipas drejtorive përkatëse.
4. Vendimi i komisionit të ankesave për miratimin apo refuzimin e ankesës së palës është përfundimtar në procedurën administrative në komunë.
5. Komisioni për ankesa brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të ankesës bën shqyrtimin e ankesës;
6. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave brenda afatit ligjor prej tridhjetë ditësh (30) nga dita e marrjes së vendimit, mund të inicojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.
7. Mandati i komisionit per shqyrtimin e ankesave do te jete dy (2) vite.

**Neni 12**
**Konflikti i interesit**

1. Anëtarët e Komisionit përjashtohen nga procesi vendimmarrës nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim te pronës së paluajtshme të komunës.
2. Anëtarët e Komisionit vlerësues përjashtohen nga procesi vlerësues nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
3. Anëtarët e Komisionit për shqyrtimin e ankesave përjashtohen nga procesi i shqyrtimit të ankesave nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

**Neni 13**
**Nënshkrimi i kontratës**

1. Bazuar në rekomandimin e komisionit vlerësues dhe pas kalimit të afatit të ankesës, Kryetari i Komunës nënshkruan kontratën me të përzgjedhurin, në të cilën kontratë përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
2. E drejta e shfrytëzimit e pronës së paluajtshme të komunës më pak se një vit, nuk mund të bartet te personat e tretë.

## II. DISPOZITAT E VEQANTA

**Neni 14**
**Mbikqyrja e kontratës**

1. Drejtoria përkatëse bën mbikqyrjen e realizimit të kontratës se a është duke e shfrytëzuar pala sipas kushteve të kontratës.

raport perfundimtar me të cilin do të rekomandoj Kryetarin e Komunës për shkëputje të njëanshme te kontratës.

3. Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të raportit përfundimtar të përgaditur nga drejtoria përkatëse dhe duke u bazuar në rekomandimin e dhënë do ta shkëpus kontratën në mënyrë të njëanshme, duke e njoftuar shtatë (7) ditë para ndërprerjes së kontratës palën kontraktuese.
4. Komuna është e obliguar që të publikojë listën e pronave të cilat i kanë dhënë në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
5. Publikimi i listës së pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim bëhët brënda shtatë (7) ditësh mga dita e nënshkrimit të kontratës.

**Neni 15**
**Mirëmbajtja e pronës së komunës**

1. Të gjithë shfrytëzuesit e pronës komunale, janë të detyruar që ato t'i mirëmbajnë dhe t'i shfrytëzojnë në mënyrën e caktuar konform kontrtaës për shfrytëzim;
2. Personat fizik dhe juridik dhe të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme të komunës, janë të detyruar të kujdesen për mbrojtjen e pronës së paluajtshme, ashtu siç parashihet me këtë Rregullore.

## III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

**Neni 16**
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohen Rregulloret me Nr. 01-013/1742 e datës 29.12.2015, dhe Nr. 02-013/372 e datës 31.03.2016, Rregulloret per vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të perkoshme në pronën publike dhe Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Vitisë te cilat bien ndesh me dispozitat e kesaj Rregullore.

**Neni 17**
Konflikti me ligjin

Në raste konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të Ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit dhe akteve tjera nënligjore që janë të aplikueshme ne Republikën e Kosovës.

**Neni 18**
Zbatimi

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive të Komunës së Vitisë.

**Neni 19**
Hyrja ne fuqi

**Neni 20**

Kjo propozim rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Vitisë dhe çertifikimi ligjor nga MAPL dhe MEF.

Propozues: Kryetari i Komunës së Vitisë
Sokol Halili